

Diskriminimi i Strehimit

Në Masacusetts është e paligjshme t'i refuzosh apartamentin një personi për arsye të:

- Racës/Prejardhjes;
- Origjinës kombëtare;
- Besimit fetar;
- Aftësive të kufizuara;
- Statusit të martuar apo me fëmijë;
- Identitetit gjinor apo seksual;
- Orientimit seksual;
- Moshës;
- Statusit të veteranit;
- Burimit të të ardhurave;
- Subvencioneve apo ndihmës për strehim.

Projekti i Strehimit të Drejtë i Uorchesterit

Për më shumë informacion, apo nëse mendoni se ju kanë diskriminuar, kontaktoni Punonjësën e Pranimeve të Diskriminimeve të Strehimit.

Zyra e të Drejtave të Njeriut dhe Personave me Aftësi të Kufizuara

Room 101 City Hall, 455 Main Street

Tel: (508) 799-8486

Email:

humanrights@worcestermma.gov

Ndihma Ligjore në Komunitet

405 Main Street, 4th Floor

Worcester, MA 01608

508-752-3718/855-CLA-LEGAL

TTY: 508-755-3260



ÇFARË DUHET TË DINI

- **Para se të transferoheni** qiradhënësi mundet t'ju ngarojë vetëm pagesën e muajit të parë e të fundit, depozitën e sigurisë dhe një çelës.
- Pas marrjes së muajit të fundit dhe depozitës së sigurisë **qiradhënësi duhet t'ju japë një faturë** për çdo pagesë.
- Qiradhënësi duhet t'ju japë gjithashtu një faturë për çdo muaj të qirasë tuaj. Formularët bosh të faturës mund të stampohen nga: <http://www.masslegalhelp.org/legal-tactics>.
- Një qiradhënësi mund të fillojë procesin e dëbimit nëse qiraja është një ditë me vonesë. Shënim: qiradhënësi juaj nuk mund t'ju ngarkojë interes ose gjobë për qira të vonuar deri në 30 ditë pas datës së caktuar.
- Nuk mund të liheni jashtë ose të dëboheni nga banesa juaj pa urdhër të gjyqtarit.
- Për **kushte të këqija**, (si minj, tartabiqë, apo mungesë e ngrohjes) telefononi Shërbimet Inspektuese të Uorchesterit, (508) 799-1198 (falas për qiramarrësit).

Mos harroni . . .

Dokumentoni mirë pagesat e qirasë, ankesat, kontaktet me qiradhënësin, përpjekjet për riparime, korrespondencën, & ngjarje të tjera me rëndësi & dokumentet në lidhje me qiranë.

Këto do t'ju ndihmojnë të zgjidhni konfliktet me qiradhënësin në gjykatë dhe jashtë saj.

Puna që siguroi bazën për këtë publikim u mbështet nga financimi me një grant me Departamentin e Strehimit dhe Zhvillimit Urban të SHBA-së. Përmbajtja dhe gjetja e materialit janë të dedikuara për publikun. Autori dhe botuesi janë vetëm përgjegjës për saktësinë e deklaratave dhe interpretimeve të përmbajtura në këtë publikim. Interpretimet tilla nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Federale.

Të drejtat dhe Përgjegjësitë e Qiramarrësve

*Një Projekt
i Ndihmës Ligjore
të Komunitetit
dhe qytetit të Uorchesterit*



Interpretues dhe materiale të përkthyer janë në dispozicion

- **A mundet ta rrisë qiranë qiradhënësi im?** Nëse keni një kontratë, qiradhënësi nuk mund ta rrisë qiranë deri në përfundim të saj. Nëse nuk keni kontratë, pronari mund ta rrisë qiranë me një njoftim me shkrim prej së paku 30 ditësh..

- **I njoftova pronarët për riparimet e nevojshme të banesës dhe nuk do t'i bëjnë riparimet. Çfarë opsionesh kam?** Telefononi Bordin tuaj Shëndetësor (ndonjëherë të quajtur "Shërbimet Inspektuese") dhe kërkonti një inspektim. Nëse është një emergjencë, si mospasja e ngrohjes gjatë dimrit, shkoni në Gjykatën e Strehimit dhe kërkonti një seancë emergjente. **Ju duhet t'i bëni këto para se të mendoni të mbani ose të përdorni paratë e qirasë për riparimet. Mospagesa e plotë e qirasë mund të bëjë që pronari të nisë një rast dëbimi.** Është roli i Shërbimeve Inspektuese dhe Gjykatës së Strehimit të ndihmojnë për ta detyruar pronarin të bëjë riparime nëse ai ose ajo nuk pranojnë ta bëjnë vetë këtë.

- **A mund të hyjë qiradhënësi në banesë pa lejen time?** Qiradhënësi **duhet** t'ju japë njoftim të arsyeshëm (zakonisht 24 orë, por ndonjëherë më pak në rast emergjence) para se ai ose ajo të hyjë në banesën tuaj për inspekte, për riparime ose t'i tregojë banesën një qiramarrësi të mundshëm.

PYETJET MË TË SHPESHTA



- **Pronari do të më dëbojë. Çfarë do të ndodhë dhe çfarë duhet të bëj?** Para se qiradhënësi të mund t'ju dëbojë, duhet të shkojë në gjykatë dhe të marrë miratimin e një gjyqtari. Para se një çështje gjyqësore të mund të fillojë, pronari duhet t'ju japë shënim me shkrim. Ju keni të drejtë të njoftoheni 14 ditë më parë nëse qiradhënësi pretendon se nuk keni paguar qiranë dhe përgjithësisht njoftim 1 muaj për çështjet e tjera.

- **Interesohesha për një apartament, por qiradhënësi nuk do të ma japë me qira sepse kam fëmijë. A lejohet kjo?** Kreysisht, jo. Në shumicën e rrethanave është e paligjshme që pronari të refuzojë dhënien me qira sepse ka fëmijë me familje. Nëse ka bojë plumbi në banesë, qiradhënësi ka përgjegjësinë ta pastrojë atë për qiramarrësit me fëmijë nën moshën 6 vjeç.

- **Aplikova për strehim publik, por m'u mohua sepse kam një dosje të vjetër penale. Çfarë mund të bëj?** Ju keni të drejtë të shpjegoni rrethanat tuaja dhe të paraqisni të dhëna që tregojnë se jeni rehabilituar dhe të shpjegoni pse do të ishit një qiramarrës i mirë. Ju gjithashtu mund të paraqisni dokumente mbështetëse dhe informacione të tjera të dobishme.

- **Po nëse kam nevojë për një ndryshim në rregullat e qiradhënësit ose një ndryshim fizik në banesë për shkak të aftësive të kufizuara?** Pronarit i kërkohet të bëjë ndryshime që lidhen me aftësinë tuaj të kufizuar, që janë të arsyeshme dhe që nuk ngarkojnë një barrë të panevojshme mbi pronarin. Nëse keni nevojë për një ndryshim fizik në banesë, mund t'ju kërkohet të paguani për atë, përveç nëse ndërtesa juaj përmban mbi 10 apartamente ose jetoni në banesa publike apo të subvencionuara.

- **Po nëse nuk mund ta përballoj qiranë time?** Aplikoni për strehim publik ose të subvencionuar apo për një kupon strehimi (si Seksioni 8). Në këto lloj strehimesh, tarifa e qirasë bazohet në sa mund të përballoni ju. Por kujdes: arritja në krye të listës së pritjes mund të zgjasë **shumë!**